



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË INFRASTRUKURËN E KOMUNES SE LIPJANIT

I. Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave dhe motit të lig në territorin e Komunës së Lipjanit, formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, në këtë përbërje:

1. Kushtrim Salihi, Drejtorati për Shërbime Publike ,Kryesues
2. Enver Elshani, Drejtorati për Planifikim Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
3. Bedri Hetemi, Drejtorati për Inspektorat , anëtar

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën fizike,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës. Raportit I bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 325 - 2061
Lipjan, më 12.01.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti